



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

KONFIRMIM DEPOZITIMI DOKUMENTACIONI NË GJYKATË KUSHTETUESE

Në datë 23 . 09 . 2025, ora 11:27 u depozitua në Gjykatën Kushtetuese dokumentacioni me dërgues Jo më për se 1/5 Deputetëve Av. Marash Ligu dhe objekt:/lëndë: shfuqizimin si të përgjithshëm me Kushtetutën e R. Sh. të vendimit nr. 57 dt. 16.09.2025 të Kuvendit të Shqipërisë

Përgjegjëse e protokoll-arkivit në Gjykatën Kushtetuese

Alketa Spahiu

Nënshkrimi (vula e sekretarisë)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tiranë, më 23.09.2025

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

JO MË PAK SE 1/5 E DEPUTETËVE, përfaqësuar në gjykim nga Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Z. Gazment Bardhi dhe Av. Marash Logu, me adresë njoftimi: Kuvendi i Shqipërisë, Blv. Dëshmorët e Kombit Nr. 4, Tiranë, me email: marashlogual@gmail.com dhe nr.tel. +355674825149.

SUBJEKT

I INTERESUAR:

KUVENDI I SHQIPËRISË, me adresë njoftimi: Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

OBJEKTI:

1. Shfuqizimi i vendimit nr. 57, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë”, të ndryshuar”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Shqipërisë.
2. Pezullimin e vendimit nr. 57 datë 16.09.2025 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë”, të ndryshuar”, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar.

BAZA LIGJORE:

Nenet 1, 2, 7, 75, 76, 78, 83, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Shqipërisë;

Nenet 49 dhe 50 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Nenet 27/1, 28, 46, 48 dhe 117 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

DREJTUAR:

GJYKATËS KUSHTETUESE

TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

E Nderuar Znj. Kryetare,

Të Nderuar Gjyqtarë,

Në datën 16.09.2025, Kuvendi i Shqipërisë, me shumicë votash, ka miratuar vendimin nr. 57/2025 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Duke qenë se vlerësojmë se ky akt vjen në kundërshtim me nenet 1, 2, 7, 70, 75, 76, 78, 83, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Shqipërisë, po parashtrojmë këtë kërkesë me faktet, provat, të drejtën e aplikueshme, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 57 datë 16.09.2025 të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

I. RRETHANAT E CËSHTJES

1. Në datën 11.09.2025, gjatë Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste, kryeministri në detyrë Edi Rama gjatë prezantimit të përbërjes së qeverisë së tij të ardhshme, ka paraqitur edhe disa ndryshime që do të kryheshin në Rregulloren e Kuvendit, të cilat kishin të bënin me numrin, emërtimin dhe fushat e përgjegjësisë së komisioneve parlamentare, si dhe reduktimin e numrit të anëërve për komision dhe të qënurit anëtar

vetëm në një komision të përhershëm. Këto ndryshime, sipas kryeministrit në detyrë, kishin për qëllim që të përshtasin strukturën e Kuvendit të Shqipërisë me objektivat e integritit evropian. Gjatë këtij prezantimi, kryeministri i bëri fakt të kryer ndryshimet, pa lënë asnjë hapësirë për diskutime, konsultime apo ndryshime të mundshme gjatë shqyrtimit parlamentar.¹

2. Katër ditë pas këtij fjalimi të kryeministrit, në datën 15.09.2025, pesë deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, Eduard Shalsi, Olta Xhaçka, Ulsi Manja dhe Evis Kushi, kanë propozuar disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Bashkëlidhur shkresës është projektvendimi dhe relacioni përkatës. Në përmbajtje të këtij projektvendimi propozohet që në nenin 19, pika 1, të Rregullores, që ka të bëjë me numrin, emërtimin dhe fushat e përgjegjësisë të komisioneve parlamentare të bëhen disa ndryshime, duke rritur numrin e tyre nga 8 (tetë) në 11 (njëmbëdhjetë), si dhe duke ndryshuar emërtimet dhe fushat e përgjegjësisë. Po ashtu, propozohet që neni 20, pika 3, e Rregullores, që iu mundëson anëtarëve të Komisionit për Integrimin Evropian që të jenë anëtarë edhe në komisione të tjera është shfuqizuar. Në relacionin shoqërues të projektvendimit jepen të njëjtat arsye si ato të bëra publike gjatë fjalimit të kryeministrit Edi Rama në Asamblenë e PS-së, në datën 11.09.2025.

3. Në të njëjtën ditë, në ora 14:00, kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, me urdhërin nr. 1, datë 15.09.2025, ka njoftuar mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë 16.09.2025, ora 10:00, me rend dite: “1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datës 12.09.2025. 2. Njoftime. 3. Projektvendimi “Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të Kuvendit”. 4. Projektvendimi “Për zgjedhjen e sekretariateve të Byrosë të Kuvendit”. 5. Projektvendimi “Për përbërjen e Byrosë së Kuvendit”.”. Po ashtu, në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë, kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, me urdhërin nr. 2, datë 15.09.2025, ka

¹ <https://ps.al/newsroom/mbahet-asambleja-kombetare-e-ps-kryetari-rama-prezanton-ekipin-e-katert-qeverises/>

njoftuar mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë 16.09.2025, ora 17:00, me rend dite: “1. Projektvendimi “Për zgjedhjen e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”.”.

4. Në datën 16.09.2025, ora 10:00, është mbledhur seanca plenare e Kuvendit, gjatë të cilës kryetari i Kuvendit, ndër të tjera, ka relatuar se është paraqitur një kërkesë nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla për ndryshimin e rendit të ditës, duke përfshirë edhe shqyrtimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Po ashtu, kryetari i Kuvendit ka relatuar edhe një kërkesë të paraqitur nga 30 (tridhjetë) deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë”, të ndryshuar”.

5. Gjatë fjalës së mbajtur nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi lidhur me këto dy kërkesa, ai ka parashtruar se thirrja e mbledhjes së Kuvendit dhe njoftimi i saj pa kaluar as 24 orë nga zhvillimi i seancës plenare është në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të Kushtetutës, ashtu si edhe nenin 27/1, pika 3, të Rregullores së Kuvendit. Kjo e fundit parashikon se thirrja e mbledhjes së Kuvendit dhe njoftimi i rendit të ditës bëhet publik si rregullt 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare. Në këtë kuptim, duke qenë një mbledhje e thirrur në kundërshtim me Rregulloren, ajo nuk mund të prodhojë asnjë pasojë. Po ashtu, lidhur me shqyrtimin e projektvendimit me procedurë të përshpejtuar, zoti Bardhi ka sjellë në vëmendje se sipas nenit 83, pika 2, të Kushtetutës, ashtu edhe nenit 28, pika 4, të Rregullores, shqyrtimi nuk mund të fillojë pa kaluar një javë nga data e paraqitjes së kërkesës në seancë plenare. Megjithatë, kryetari i Kuvendit ka vijuar me hedhjen e dy kërkesave në votim dhe me shumicë votash është vendosur miratimi i tyre.

6. Pas miratimit të dy kërkesave, kryetari i Kuvendit ka njoftuar thirrjen e mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për shqyrtimin e

projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, dhe mbledhjen e Kuvendit sërish në ora 12:30 për vijimin e shqyrtimit dhe miratimit të projektvendimit. Gjatë mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, 5 (pesë) anëtarët, deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kanë parashtruar se këto ndryshime, përveçse bëhen në mënyrë të njëanshme, duke shkelur për herë të dytë traditën e miratimit me konsensus ndërpartiak, shkelin në mënyrë flagrante dispozitat e Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, të cilat rregullojnë mënyrën e thirrjes dhe njoftimit të mbledhjes së Kuvendit, ashtu edhe shqyrtimin e projektvendimeve me procedurë të përsheptuar (shih nenet 78, pika 2; 83, pika 2, të Kushtetutës; nenet 27/1, pika 3; 28, pika 4, të Rregullores së Kuvendit).

7. Pas rifillimit të seancës plenare, deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kanë parashtruar sërish qëndrimin e tyre sa i përket shkeljeve të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ka njoftuar se për projektvendimin për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit nuk do të ketë diskutime, çka sërish është kontestuar nga deputetët e opozitës si shkelje e nenit 75, pika 2, e Kushtetutës, e lexuar së bashku me nenet 46, pika 1, dhe 48, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, pasi i mohohet e drejta e fjalës deputetëve që dëshirojnë të diskutojnë rreth ndryshimeve të propozuara. Edhe ky qëndrim është injoruar nga kryetari i Kuvendit, i cili ka vijuar me votimin dhe miratimin e projektvendimit për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit (shih provën nr. 7). Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, është miratuar me shumicë votash. **[Vendimi nr. 57, datë 16.09.2025 i Kuvendit të Shqipërisë]**

8. Në seancën plenare të datës 16.09.2025, ora 17:00 janë miratuar propozimet e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për përbërjen e kryesive (kryetar, zëvendëskryetar, sekretar) të komisioneve të përhershme të Kuvendit. Kjo mbledhje është

bojkotuar nga përfaqësuesit e opozitës në shenjë proteste ndaj ndryshimeve të njëanshme në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.

II. E DREJTA E APLIKUESHME

9. Kushtetuta e Shqipërisë:

- (i) **Neni 1** parashikon: “1. *Shqipëria është Republikë parlamentare.*”.
- (ii) **Neni 2** parashikon: “1. *Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. 2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.*”.
- (iii) **Neni 7** parashikon: “*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.*”.
- (iv) **Neni 70** parashikon: “1. *Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk me lidhen me asnjë mandat detyrues.*”.
- (v) **Neni 75** parashikon: “2. *Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.*”.
- (vi) **Neni 76** parashikon: “1. *Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët.*”.
- (vii) **Neni 78** parashikon: “2. *Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.*”.
- (viii) **Neni 83** parashikon: “2. *Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.*”.
- (ix) **Neni 131** parashikon: “Gjykata Kushtetuese vendos për: a) *pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet*

në nenin 122; c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;”.

- (x) **Neni 134** parashikon: “1. Gjkata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: c) jo më pak se një të pestës së deputetëve.”.

10. Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”:

- (i) **Neni 49** parashikon: “1. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit.”.
- (ii) **Neni 50** parashikon: “1. Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 49, të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.”.

11. Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë:

- (i) **Neni 27/1** parashikon: “1. Rendi i ditës i seancës plenare përmban çështjet që janë parashikuar në kalendarin 3-javor të punimeve të Kuvendit dhe që kanë përfunduar shqyrtimin në komisionet parlamentare. 2. Për çështje të tjera, të parashikuara në këtë Rregullore, por që nuk janë pjesë e kalendarit, Kryetari i Kuvendit dhe/pse Konferenca e Kryetarëve miratojnë një rend dite të veçantë. 3. Rendi i ditës miratohet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet publik si rregull 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare.”.
- (ii) **Neni 28** parashikon: “1. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve, Kuvendi mund të shqyrtojë një

projektligj me procedurë të përshpejtuar. 2. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, me përjashtim të shkronjës “dh”. Projektligji që synon për afrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian nuk shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar. 3. Kërkesa për procedurë të përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjit paraqitet me shkrim te Kryetari i Kuvendit, i cili ia njofton Kuvendit në seancën plenare më të parë. Pas njoftimit të Kryetarit dëgjohet një folës pro dhe një folës kundër për jo më shumë se 10 minuta. Kryetari i Kuvendit i paraqet Kuvendit për votim projektvendimin përkatës, në të cilin përcaktohet data e shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, afati brenda të cilit mund të propozohen amendamente dhe data e shqyrtimit në seancë plenare. Konferenca e Kryetarëve mund të përcaktojë kohën e debatit në seancë plenare, duke respektuar rregullin e parashikuar në nenin 48, pika 3 të kësaj Rregulloreje. 4. Afati, brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare, nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare.”.

- (iii) **Neni 46** parashikon: “1. Çdo deputet që dëshiron të diskutojë për një çështje të përfshirë ose të papërfshirë në rendin e ditës duhet të regjistrohet në sekretari para fillimit të seancës plenare. Lista e diskutuesve të regjistruar i bëhet e njohur deputetëve në fillim të seancës plenare.”.
- (iv) **Neni 48** parashikon: “1. Çdo deputet ka të drejtë të flasë jo më shumë se 10 minuta, me përjashtim kur në Rregullore parashikohet ndryshe. Deputeti nuk mund të flasë më shumë se një herë për thelbin e së njëjtës çështje dhe nuk mund të marrë nga koha e një diskutuesi tjetër.”.
- (ii) **Neni 117** parashikon: “Cdo deputet ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe

shqyrtimin e projektligjeve. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”.

12. Ligji nr. 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit”, i ndryshuar:

(i) **Neni 4** parashikon: “3. Deputeti ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e tij dhe të zgjedhësve që ai përfaqëson nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave dhe pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës.”.

III. ANALIZA LIGJORE

A. *Lidhur me legjitimimin e kërkuarit*

A.1 *Për legjitimimin ratione personae*

13. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar listën e çështjeve, shqyrtimi i të cilave është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese. Ndër të tjera, në nenin 131, gërma “c”, përcaktohet se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Nga interpretimi i kësaj dispozite del qartë se pretendimet për papajtueshmëri me Kushtetutën apo marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria bën pjesë të akteve normative që prodhojnë organet qendrore apo vendore mund të ngrihen dhe të shqyrtohen vetëm nga Gjykata Kushtetuese. Kjo dispozitë pasqyron qartë një prej kompetencave thelbësore të Gjykatës Kushtetuese për të garantuar që veprimtaria e organeve publike, e mishëruar nëpërmjet akteve të tyre, të jetë në përputhje dhe në respekt të Kushtetutës.

14. Ndërsa, në nenin 134, të Kushtetutës, gjejmë të përcaktuar listën e subjekteve që kanë të drejtë të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Këto subjekte ndahen në dy kategori. Të parat ku përfshihen Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit konsiderohen si subjekte të pakushtëzuara, pasi ato mund ta investojnë Gjykatën, pa pasur nevojë të provojnë interesin e tyre konkret në

cështjen objekt shqyrtimi. Ndërsa, kategoria e dytë ku përfshihen Kryetari i KLSH-së, gjykatat, komisionerët e krijuar me ligj, KLGJ-ja dhe KLP-ja, organet e qeverisjes vendore, bashkësitë fetare, partitë politike, organizatat dhe individët, duhet të provojnë interesin e tyre konkret në cështjet objekt shqyrtimi, në mënyrë që të legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës.

15. Këto dispozita i gjejmë të reflektuara edhe në Ligjin organik nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” (në vijim “Ligji nr. 8577/2000”), përkatësisht në nenin 49 të tij. Konkretisht, neni 49 përcakton se të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit. Kjo dispozitë përmban në vetvete elementë të të përcaktimeve kushtetuese sa i përket kompetencës së Gjykatës Kushtetuese, por edhe të drejtës së pakushtëzuar të jo më pak se 1/5 së deputetëve të Kuvendit për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues.

16. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se 30 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për të shfuqizuar vendimin nr. 57, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Shqipërisë për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Gjykata Kushtetuese është shprehur se Rregullorja është një akt juridik në të cilin gjejmë pasqyrim disa dispozita të nivelit kushtetues dhe ka si qëllim të vendosë rregulla mbi veprimtarinë dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit (*shih vendimin nr. 33, datë 24.06.2010*). Shqyrtimi i kësaj kërkesë është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në zbatim të nenit 131, gërma “c”, të Kushtetutës, ashtu si edhe subjekti jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit bën pjesë në kategorinë e subjekteve të pakushtëzuara që mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues, në zbatim të nenit 134, pika 1, gërma “c”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 8577/2000. Në këtë kuptim, kërkuesi gëzon *legitimitatio personae*.

A.2 *Për legjitimimin ratione temporis*

17. Përveçse çështja objekt shqyrtimi duhet të jetë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131, të Kushtetutës, dhe kërkuesi duhet të gëzojë legjitimimin personal në kuptim të nenit 134, të Kushtetutës, një kusht tjetër thelbësor që duhet të plotësojë një kërkesë për t'u pranuar për shqyrtim është respektimi i afatit. Në rastin e kontrollit kushtetues të akteve normative, afatin e gjejmë të përcaktuar në nenin 50, pika 1, të Ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite afati për paraqitjen e një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese është dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të aktit. Në rastin konkret, vendimi nr. 57 i Kuvendit është miratuar në datën 16.09.2025 dhe ka hyrë në fuqi menjëherë, çka do të thotë se kjo kërkesë po paraqitet brenda afatit ligjor. Në këtë kuptim, kërkuesi gëzon *legitimitatio temporis* për paraqitjen e kësaj kërkesë.

B. *Lidhur me cënimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve*

18. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, i sanksionuar në nenin 7, bën pjesë në listën e parimeve themelore të Kushtetutës së Shqipërisë. Në sistemet demokratike, ky parim synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Ky koncept i sistemit të qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Megjithëse këto pushtete janë të ndarë në aspektin e autonomisë funksionale dhe në pavarësinë e ushtrimit të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta, ato balancojnë njëri-tjetrin nëpërmjet bashkëveprimit ndërmjet tyre për ushtrimin e detyrave, duke respektuar, nxitur, mbështetur dhe kontrolluar njëri-tjetrin. Parimi i ndarjes së pushteteve nuk do kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes garantohe vetëm nëpërmjet sistemit të kontrolleve dhe ekuilibreve.

Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve (shih vendimin nr. 11/2004 të Gjykatës Kushtetuese; shih Bashkim Dedja, Konferenca “Forcimi i Shtetit të së Drejtës”, 2011).

19. Formulimi që gjendet në nenin 7 të Kushtetutës tonë nënkupton se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Në varësi të kësaj ndarjeje, fusha e ushtrimit të kompetencave nga institucionet e ndryshme kushtetuese varet nga fakti se cilit pushtet i përket institucioni, nga vendi i tij mes institucioneve të tjera dhe nga raportet e tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (shih vendimet nr. 9, datë 26.02.2016; nr. 16, datë 10.04.2015; nr. 36, datë 01.06.2015; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në republikat parlamentare, siç është rasti i Shqipërisë, për shkak se pushteti ekzekutiv (qeveria) buron nga Parlamenti (shumica parlamentare), dhe kryeministri, është njëkohësisht edhe kryetari i partisë në pushtet, shpeshherë vija ndarëse ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ mund të duket e paqartë, duke krijuar përshtypjen e një bashkimi apo shkrirje ndërmjet këtyre dy pushteteve. Megjithatë, më shumë jemi në kushtet e një keqkuptimi apo deformimi të sistemit, dhe në asnjë rast nuk duhet nënkuptuar se ndërmjet këtyre dy pushteteve nuk ekziston një ndarje e qartë në drejtim detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave konkrete që iu ka ngarkuar Kushtetuta. Është sigurisht detyrë e pushteteve dhe përfaqësuesve respektivë për të mbrojtur pavarësinë e tyre në kufijtë e njohur nga Kushtetuta, duke mos lejuar që një pushtet arbitrar të përvetësojë kompetencat, të drejtat dhe përgjegjësitë e një pushteti tjetër. Për këtë qëllim, në rast të cënimit të kompetencave, Kushtetuta jonë, ashtu si edhe kushtetutat e tjera të vendeve

demokratike, iu njohin të drejtën pushteteve për t'iu drejtuar organeve gjyqësore, e në rastin shqiptar Gjykatës Kushtetuese.

21. Si pjesë e pavarësisë së pushtetit legjislativ në Shqipëri, është edhe parashikimi në nenin 75, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë, i cili sanksionon se Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve. Pra, qartazi në miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, Kushtetuta i ka dhënë kompetencë ekskluzive vetëm Kuvendit, pushtetit ligjvënës, duke përjashtuar dy pushtetet e tjera, ekzekutivin dhe gjyqësorin. Kjo duket të jetë fryma edhe e nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, në të cilën specifikohet se nismën për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit mund ta ndërmarrin vetëm deputetët, në ndryshim të qartë me nismën ligjvënëse të cilën mund ta ndërmarrin edhe Këshilli i Ministrave dhe/ose 20 mijë zgjedhës. Organizimi dhe funksionimi mbi bazën e një Rregulloreje, që iniciohet, shqyrtohet dhe miratohet ekskluzivisht nga Kuvendi, ka përjashtuar çdo ndërhyrje të mundshme që mund të bëhet nga pushteti ekzekutiv për t'i diktuar pushtetit legjislativ norma të caktuara. Në të kundërt, ndërhyrja e pushtetit ekzekutiv për t'i diktuar pushtetit legjislativ përmbajtjen e Rregullores së këtij të fundit, qoftë në drejtim të organizimit, ashtu edhe të funksionimit, përbën një cënim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

22. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se në Asamblenë Kombëtare të Partisë Socialiste, në datën 11.09.2025, kryetari i pushtetit ekzekutiv, kryeministri Edi Rama, gjatë kohës që po prezantonte kabinetin e tij qeveritar për katër vitet e ardhshme, paraqiti edhe ndryshimet që do pësonte struktura e Kuvendit, përkatësisht komisionet parlamentare, qoftë sa i përket numrit, emërimit, përbërjes, drejtimit dhe përbërjes së tyre. Pesë ditë më pas, Kuvendi miratoi ndryshimet e paraqitura nga kryeministri në Rregulloren e Kuvendit, duke provuar kështu se efektivisht pushteti ekzekutiv kishte ndërhyrë për t'i diktuar pushtetit legjislativ mënyrën se si do të ristrukturoheshin komisionet parlamentare. E gjitha kjo vendimmarrje nuk mund të shihet ndryshe veçse si një ndërhyrje flagrante e pushtetit ekzekutiv në kompetencat e pushtetit legjislativ, në shkelje të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, në shkelje të nenit 7 të Kushtetutës.

23. Sjellim në vëmendje se në kohën kur komunikoheshin këto ndryshime, legjislatura e re akoma nuk ishte mbledhur nga Presidenti i Republikës, deputetët të ishin betuar dhe të kishte filluar veprimtaria parlamentare. Në fakt, kjo qasje e pushtetit ekzekutiv, i cili ka zgjeruar në vijimësi kompetencat e saj në kurriz të pushteteve të tjera, qoftë atyre që njihen si pushtete horizontale (legjislativ, gjyqësor), ashtu edhe pushtetit vertikal (vendor), kërkon që t'i nënshtrohet një kontrolli strikt kushtetues dhe të disiplinohet me qëllim që ky precedent të arkivohet dhe raste të ngjashme të mos përsëriten në të ardhmen. Në të kundërt, në vitet e ardhshme, pushteti legjislativ mund të vërejë të tjera kompetenca, përgjegjësi dhe detyra që i "rrëmbehen" padrejtësi nga pushtetit ekzekutiv (qeveria) dhe kreu i tij (kryeministri).

C. Lidhur me shkeljet në thirrjen e mbledhjes së Kuvendit

24. Neni 78, pika 2, e Kushtetutës së Shqipërisë sanksionon se mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë. Referuar kësaj dispozite, çdo mbledhje e deputetëve, qoftë në seancë plenare, ashtu edhe në komisione parlamentare, e cila nuk thirret në përputhje me parashikimet e Rregullores, është e pavlefshme dhe nuk sjell asnjë pasojë. Kjo duhet nënkuptuar që vendimmarrjet e një mbledhje të tillë janë nul nga pikëpamja kushtetuese, por pasur parasysh faktin se ky nuk është një proces automatic, është e kuptueshme që nuliteti i mbledhjes (seancë plenare/komision parlamentar), ashtu si edhe nuliteti i vendimmarrjeve (vendim/ligj/rezolutë), duhet të jetë objekt shqyrtimi dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Duke qenë se neni 78, pika 2, është një dispozitë referuese, në këtë rast kontrolli kushtetues do të shtrihet ndaj respektimit të dispozitave konkrete të Rregullores për thirrjen dhe mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare.

25. Me qëllim që kjo dispozitë referuese të marrë kuptim në zbatimin konkret të Kuvendit të Shqipërisë, neni 27/1, pika 3, e Rregullores së Kuvendit ka parashikuar se

mbledhjet e Kuvendit së bashku me rendin e ditës thirren dhe njoftohen si rregull 7 (shtatë) ditë përpara, por në çdo rast jo më vonë se 2 (dy) ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare. Kjo dispozitë duket që krijon një hapësirë interpretimi dhe aplikimi nga 2 ditë përpara (minimumi) deri në 7 ditë përpara (maksimumi). Gjatë legjislaturës së kaluar, zhvillimi i seancave plenare, së bashku me rendin e tyre të ditës, është njoftuar brenda ditës së marte për seancat e zhvilluara ditën e enjte (rregulli i përgjithshëm sipas nenit 40/1, gërma “c”, e Rregullores), dhe brenda ditës së premte për seancat e zhvilluara, ditën e hënë (në raste të veçanta). Në këto kushte, kryetarët e Kuvendit të legjislaturës së mëparshme, përkatësisht znj. Lindita Nikolla dhe znj. Elisa Spiropali, së bashku me stafet e tyre përkatëse janë kujdesur që njoftimet të kryhen në kohën, duke respektuar afatin minimal të parashikuar nga Rregullorja e Kuvendit.

26. Parashikimi i një afati për njoftimin e mbledhjes së Kuvendit në seancë plenare dhe rendit të ditës nuk është thjesht dhe vetëm një aspekt formal i punës parlamentare. Rregullat e njoftimit kanë për qëllim që t’i japin mundësi që të programojnë kohën për të siguruar pjesëmarrjen efektive në seancat plenare, ashtu si edhe duke u njohur me çështjet që do të diskutohen gjatë seancës, të ketë mundësi për t’u përgatitur në mënyrë që t’i kontribuojnë efektivisht procesit ligjbërës, kontrollues apo zgjedhor. Parapërgatitja është sigurisht e rëndësishme edhe për administratën e Kuvendit, ashtu edhe për stafet politike të deputetëve, të cilët marrin masat dhe përgatisin materialet teknike, me qëllim asistimin dhe lehtësimin e punës së deputetëve gjatë seancës plenare. Pjesëmarrja e deputetit në seancë plenare nuk duhet kuptuar thjesht si prania fizike e tij, por si një mundësi që ai ka për të shprehur mendimet e zgjedhësve, për të bërë pyetje, kërkuar sqarime, propozuar ndryshime etj. Në këtë kuptim, për një deputet është thelbësore që njoftimi i mbledhjeve të Kuvendit, pavarësisht formatit seancë plenare apo komision parlamentar, ashtu si edhe përmbajtja e rendit të ditës të kryhet në përputhje me afatet e parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit.

27. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se megjithë parashikimet e qarta kushtetuese dhe ligjore, ashtu edhe një praktikë të konsoliduar parlamentare, kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, duke injoruar parashikimet ligjore të nenit 78, pika 2, të Kushtetutës, ashtu edhe të nenit 27/1, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, ka urdhëruar thirrjen e Kuvendit në dy seanca plenare në datën 16.09.2025, ora 10:00 dhe ora 17:00. Vetë urdhëri i kryeparlamentarit Peleshi mban datën 15.09.2025, ndërkohë që njoftimi efektiv i deputetëve është bërë në orën 14:00. Nga përmbajtja e urdhërave nr. 1 dhe nr. 2, datë 15.09.2025, ashtu edhe nga koha e njoftimit të tyre, del qartë në fakt se afati minimal prej 2 ditësh (48 orësh) nuk është respektuar, pasi thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së Kuvendit në seancë plenare, ashtu edhe rendit të ditës, është bërë në më pak se 24 orë përpara datës dhe orës së caktuar për seancën plenare. Kjo shkelje sigurisht nuk mund të justifikohet me eksperiencën e pakët të kryetarit të Kuvendit në këtë detyrë, i cili përveçse është në mandatin e tij të tretë si deputet, njëkohësisht asistohet nga shërbimet e Kuvendit, të cilët gëzojnë njohuritë e nevojshme, por edhe mbartin një kujtesë të gjatë të praktikës parlamentare për zhvillimin e të tillave seanca plenare.

28. Megjithatë, edhe sikur eksperiencia parlamentare, ashtu si edhe asistenca e stafëve teknike të ishte e pamjaftueshme për të shpëtuar kryetarin e Kuvendit për ta filluar detyrën e tij me shkelje të hapura të Kushtetutës dhe Rregullores, nga përmbajtja e procesverbalit të datës 16.09.2025 të seancës plenare të Kuvendit, ashtu edhe nga procesverbali i të njëjtës datë të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, rezulton se kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ashtu si edhe deputetë të tjerë të opozitës, kanë sjellë në vëmendje se thirrja dhe zhvillimi i kësaj mbledhje është në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të Kushtetutës, ashtu si edhe me nenin 27/1, pika 3, të Rregullores së Kuvendit. Ky konstatim ka rënë në veshin e shurdhër të kryetarit të Kuvendit, ashtu si edhe të shumicës përlegamentare, të cilët kanë vijuar shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimeve të Rregullores së Kuvendit, sipas vendimmarrjeve politike që iu ishin komunikuar nga kryeministri në Asmblenë Kombëtare të Partisë Socialiste në datën 11.09.2025.

29. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, del qartë se mbledhja e Kuvendit në seancë plenare, ashtu si edhe njoftimi i rendit të ditës është kryer në kundërshtim me nenin 27/1, pika 3, të Rregullores, çka në përputhje me nenin 78, pika 2, të Kushtetutës, do të thotë se kjo mbledhje është nul dhe nuk sjellë asnjë pasojë, duke shfuqizuar edhe të gjitha vendimmarrjet e kësaj seance plenare, përfshirë edhe vendimin nr. 57, datë 16.09.2025 i Kuvendit “Për disa ndryshime në vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Një interpretim dhe zbatim i ndryshëm i nenit 27/1, pika 3, të Rregullores dhe nenit 78, pika 2, të Kushtetutës, i mundëson kryetarit të Kuvendit dhe shumicës parlamentare që ta shndërrojnë në një praktikë abuzive thirrjen e mbledhjes së Kuvendit dhe njoftimin e rendit të ditës së saj, në varësi të orekseve politike të tyre për miratimin e akteve të caktuara që iu diktohen me urdhër nga kryeministri, siç edhe ndodhi në rastin konkret.

Ç. Lidhur me shkeljet në shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar

30. Neni 83, pika 2, e Kushtetutës së Shqipërisë përcakton se Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së përshpejtuar. Këtë dispozitë e gjejmë të reflektuar edhe në nenin 28 të Rregullores së Kuvendit, e cila përcakton se afati, brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare. Këto dy dispozita kanë autorizuar Kuvendin që në rast nevojë dhe urgjence të mund t'i shmanget procedurës normale parlamentare të shqyrtimit të projektligjeve duke respektuar dy kushte, përkatësisht kërkesa duhet të bëhet nga Qeveria ose 1/5 e deputetëve dhe shqyrtimi e miratimi i projektligjit nuk mund të bëhet pa kaluar një javë nga vendimi i Kuvendit për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar.

31. Neni 117 i Rregullores së Kuvendit, që ka të bëjë me ndryshimin e Rregullores, përcakton se propozimet për ndryshime ndjekin të njëjtën procedurë parlamentare të parashikuar për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve. Nga kjo dispozitë mund të deduktohet se rregullat për shqyrtimin e projektligjeve aplikohen *mutatis mutandis* për shqyrtimin e amendamenteve në Rregulloren e Kuvendit. Kjo përfshin edhe rregullat që kanë të bëjnë me procedurën e përshpejtuar qoftë në kuptim të subjekteve që mund të paraqesin kërkesën (Këshilli i Ministrave ose një e pesta e deputetëve të Kuvendit), ashtu edhe sa i përket afatit të shqyrtimit dhe miratimit të amendamenteve me procedurë të përshpejtuar (jo më parë se një javë nga data e fillimit të shqyrtimit me procedurë të përshpejtuar). Vetë aplikimi i procedurës së përshpejtuar duke u mbështetur të neni 83, pika 2, e Kushtetutës, ashtu si edhe neni 28, pika 2, e Rregullores së Kuvendit, nënkupton që Rregullorja trajtohet njësoj si ligjet, dhe projektvendimet njësoj si projektligjet e tjera.

32. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 57, datë 16.09.2025 ka vendosur shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të propozimit të katër deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Ky vendim është miratuar në datën 16.09.2025. Duke marrë në konsideratë nenin 121/1 të Rregullores së Kuvendit, sipas të cilit kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati, atëherë afati 1-javor ose 7-ditor impononte që shqyrtimi dhe miratimi i këtyre ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit nuk mund të bëhej para datës 24.09.2025 (data 23.09.2025 është dita e shtatë). Megjithatë, siç rezulton nga procesverbali i seancës plenare të datës 16.09.2025, ashtu edhe nga procesverbali i datës 16.09.2025 i Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, shqyrtimi i projektvendimi për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, ka filluar menjëherë pas miratimit të vendimit për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar. Po ashtu, vendimi nr. 57, datë 16.09.2025 për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit është miratuar brenda të njëjtës ditë.

33. Kjo mënyrë e të vepruarit nga kryetari i Kuvendit, ashtu si edhe nga shumica parlamentare është qartazi në shkelje të nenit 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 28, pika 4, e Rregullores së Kuvendit, pasi me vetëdije të plotë, si dhe të vënë në dijeni në mënyrë të përsëritur nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kanë shqyrtuar dhe miratuar ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, brenda të njëjtës ditë që ishte njoftuar kërkesa nga kryetari i Kuvendit për shqyrtimin e ndryshimeve të propozuara me procedurë të përshpejtuar. Sjellim në vëmendje se afati normal 2-javor (neni 69, pika 3 e Rregullores), dhe afati përjashtimor 1-javor (nenin 83, pika 2, e Kushtetutës; neni 28, pika 4, e Rregullores), kanë për qëllim që të sigurojnë një kohë të përshtatshme për shqyrtimin e duhur të projektligjeve, ashtu si edhe të projektvendimeve që lidhen me Rregulloren e Kuvendit. Duhet mbajtur në konsideratë, se ashtu siç është shprehur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 48/2024, Rregullorja është një akt sui generis me natyrë atipike, i cili për sa kohë nuk i nënshtrohet në mënyrë të shprehur kontrollit të asnjë juridiksionit tjetër gjyqësor dhe as nuk ka ndonjë ndalim të shprehur për ushtrimin e kontrollit kushtetues, arrihet në përfundimin se shqyrtimi i pajtueshmërisë së dispozitave të kundërshtuara të Rregullores përfshihet në juridiksionin kushtetues (shih vendimin nr. 48/2014, paragrafi 29, i Gjykatës Kushtetuese).

D. *Lidhur me cënimin e parimit të demokracisë përfaqësuese (liria e shprehjes)*

34. Neni 1, pika 1, e Kushtetutës së Shqipërisë sanksionon se Shqipëria është Republikë Parlamentare. Ndërsa, në nenin 2, pika 2, përcaktohet se populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Më tej, në nenin 70, pika 1, të Kushtetutës, parashikohet se deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të sipërcituara mund të deduktohet natyra parlamentare e Republikës tonë, e cila i jep Kuvendit një pozitë të vecantë në raport me organet e tjera të pushtetit. Kuvendi, i cili është organi më i lartë legjislativ, ushtron krahas funksionit ligjvënës, edhe dy funksione të tjera shumë të rëndësishme, përkatësisht funksionin kontrollues dhe zgjedhor. Pozita dhe pushteti që i

është dhënë Kuvendit mishërohet nëpërmjet deputetëve, përfaqësues të popullit. Pra, janë pikërisht deputetët, të cilët ushtrojnë funksionet që Kushtetuta dhe ligji i kanë ngarkuar Kuvendit.

35. Nga parimi i demokracisë përfaqësuese rrjedh detyrimi i deputetit që mandatin e besuar nga zgjedhësit ta ushtrojë realisht. Mandati i deputetit duhet të kuptohet, së pari, si një akt përfaqësimi individual që lidhet me deputetin si individ dhe më pas me partinë politike ku ai bën pjesë. Edhe pavarësia e mandatit të deputetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, i shërben forcimit të statusit përfaqësues parlamentar, duke garantuar edhe të drejtat e pakicës parlamentare brenda sistemit të vendimmarrjes me shumicë. Deputeti është i lirë të ushtrojë funksionin e tij në mënyrën më të mirë të mundshme të zgjedhur prej tij. Ai pranon në mënyrë krejtësisht të lirë mandatin e tij dhe vendos me përgjegjësinë e tij të plotë për mënyrën e ushtrimit të mandatit (shih vendimin nr. 1/2022; nr. 44/2011 të Gjykatës Kushtetuese).

36. Koncepti i mandatit parlamentar përmban detyrimin e përfaqësimit real të zgjedhësve. Populli merr pjesë në vendimmarrjen parlamentare nëpërmjet tërësisë së anëtarëve të tij dhe për këtë qëllim duhet të garantohet pjesëmarrja e të gjithë deputetëve në vendimmarrje sipas kuadrit kushtetues. Sipas Gjykatës, vetëm duke qenë plotësisht efektiv, pra i përfaqësuar tërësisht me të gjithë anëtarët e tij, parlamenti mund të realizojë funksionin e tij demokratik. Nëse një deputet, për arsye të ndryshme, ndalohej ose pengohet të ushtrojë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë çënohet parimi i përfaqësimit, si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlamentar gjatë gjithë legjislaturës (shih vendimet nr. 1/2022; nr. 44/2011 të Gjykatës Kushtetuese). Në kuptim të sa më sipër, Gjykata thekson se parimi i demokracisë përfaqësuese i garanton çdo anëtar të Kuvendit që të ushtrojë, gjatë veprimtarisë parlamentare, të drejtat që burojnë nga statusi i tij kushtetues, i përcaktuar në nivel kushtetues, konkretisht në nenin 70 të Kushtetutës i parë së bashku me nenin 81, pika

1, të saj, të cilat janë zbërthyer në vijim në parashikimet e ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit” (ligji nr. 8550/1999) dhe ato të Rregullores.

37. Më konkretisht, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8550/1999, deputeti merr pjesë rregullisht në seanca plenare, në komisione, si dhe në të gjithë veprimtarinë e Kuvendit, në përputhje me kërkesat e Rregullores. Ai ka të drejtë të ushtrojë vetë dhe në kuadrin e veprimtarisë së komisionit kontrollin e zbatimit të ligjeve, vendimeve e akteve të tjera të nxjerra nga Kuvendi, nga Këshilli i Ministrave, nga ministritë, nga organet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e tij dhe të zgjedhësve që ai përfaqëson nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave e pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës. Sipas nenit 5 të këtij ligji, deputeti takohet periodikisht me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata. Deputeti përfaqëson zgjedhësit duke iu marrë mendime apo duke iu dhënë shpjegime për projektligje, amendamente, vendime, rezoluta ose deklarata që shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend. Kurse sipas nenit 40 të Rregullores, deputetët janë në veprimtari parlamentare kur ata marrin pjesë në seancë plenare, në mbledhjet e komisioneve/nënkomisioneve ose të këshillave, në veprimtari brenda ose jashtë vendit ose veprimtari në zonat zgjedhore, si dhe kur janë në mbledhjet e grupeve parlamentare ose në grupe të ndryshme pune të ngritura nga Kuvendi ose nga komisionet (shih vendimin nr. 48/2024 të Gjykatës Kushtetuese).

38. Në kuptim të të drejtave që burojnë nga statusi i deputetit, liria e shprehjes gëzon një nivel të lartë mbrojtjeje, që reflektohet në parashikimin e imunitetit parlamentar sipas nenit 73, pika 1, të Kushtetutës, garanci që shërbejnë për të siguruar pavarësinë e Kuvendit në kryerjen e detyrave të tij. Kjo liri i shërben mbrojtjes së interesave të organit ligjvënës në tërësi dhe nuk duhet kuptuar thjesht si një mbrojtje që u ofrohet deputetëve individualisht. Edhe GJEDNJ-ja i ka kushtuar rëndësi të madhe lirisë së shprehjes së deputetëve në përgjithësi dhe në veçanti asaj të deputetëve të opozitës, gjë që justifikon një kontroll më të rreptë të masave disiplinore të vendosura ndaj tyre. Ajo ka nënvizuar vazhdimisht rëndësinë e lirisë së shprehjes për deputetët, për shkak se është fjalë politike

par excellence. Prandaj, ndërhyrja në lirinë e shprehjes së një anëtari të parlamentit të opozitës kërkon shqyrtim më të ngushtë nga ana e asaj gjykate (shih Karácsony dhe të tjerë kundër Hungarisë, datë 17 maj 2016, §§ 137, 140).

39. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se megjithëse deputetët e pakicës parlamentare kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur që t’iu jepet e drejta e fjalës për të diskutuar lidhur me projektvendimin për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, nga ana e kryetarit të Kuvendit, Niko Peleshi është komunikuar se nuk do të ketë diskutime. Kjo sipas tij i referohet një praktike parlamentare të pashkruar, por në fakt Kushtetuta, Rregullorja, ashtu si edhe Ligji nr. 8550/1999 “Statusi i Deputetit”, i ndryshuar, nuk parashikojnë në asnjë rast kufizimin e fjalës së deputetit për të diskutuar lidhur me projektligje apo projektvendime që shqyrtohen dhe miratohen gjatë seancës plenare. Liria e shprehjes së deputetit, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të sipërcituar, është pjesë e parimit të demokracisë përfaqësuese, dhe aplikimi i kësaj të drejte nuk mund të lihet në diskrecionin arbitrar të kryetarit të Kuvendit.

40. Në këtë kuptim, vendimmarrja e kryetarit të Kuvendit për të mos lejuar diskutimet e deputetëve që dëshironin të shprehin mendimet e tyre, vlerësojmë se çënon parimin e demokracisë përfaqësuese, në drejtim të lirisë së shprehjes së deputetëve, e për rrjedhojë përbën një tjetër shkelje të Kushtetutës (shih nenet 1, 2, 70 dhe 75), Rregullores së Kuvendit (shih nenet 46 dhe 48), Ligjit nr. 8550/1999 (shih nenin 4, pika 3), krahas shkeljeve të evidentuara më lart që shoqëruan procedurën e ndjekur për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit.

DH. *Lidhur me pezullimin e vendimit nr. 57, datë 16.09.2025 të Kuvendit*

47. Neni 45 i Ligjit nr. 8577/2000 parashikon se Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes

së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hujë në fuqi. Kjo dispozitë që autorizon Gjykatën Kushtetuese të vendosë si masë të ndërmjetme pezullimin e zbatimit të një ligji ose të një akti, ka për qëllim që të ruajë në gjendjen aktuale të drejtat dhe interesat që mund të preken nga zbatimi i aktit. Vendimi për pezullimin nuk paragjykon vendimin përfundimtar të Gjykatës, por iu jep mundësi palëve që i janë drejtuar Gjykatës që të mos cënohen në të drejtat dhe interesat e tyre përsa kohë vazhdon gjykimi.

48. Ndryshe nga proceset gjyqësore civile apo administrative, standardi i vendosur në këtë rast ka të bëjë vetëm me ardhjen e pasojave që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, pa pasur nevojë që të vijnë dëmë të rënda dhe të parikuperueshme. Duke u kthyer në rastin konkret, është e qartë se nga zbatimi i vendimit nr. 57, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Shqipërisë, vijnë pasoja që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit, ashtu edhe të anëtarëve të tij. Kjo pasi pas miratimit të kryesive të komisioneve (kryetar, zëvendëskryetar, sekretar), vetëm me përfaqësues të shumicës parlamentare, së shpejti pritet që të miratohet edhe anëtarësia dhe të fillojë veprimtaria e komisioneve parlamentare. Por, në eventualitetin që këto ndryshime do të shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, atëherë gjithë veprimtaria parlamentare e kryer nga këto komisione, qoftë në drejtim të procesin ligjvënës, funksionit zgjedhor, ashtu edhe të mbikëqyrjes parlamentare, vihet në pikëpyetje, duke krijuar një situatë pasigurie juridike sa i përket legjitimitetit të akteve juridike që do të prodhojë Kuvendi, me strukturën e tij të rishikuar, në vlerësimin tonë në kundërshtim me Kushtetutën.

49. Në këtë kuptim, kërkesa për pezullimin e vendimit nr. 57, datë 16.09.2025, ka për qëllim mbrojtjen e legjitimitetit të organeve të Kuvendit dhe vendimmarrjeve eventuale të tij, të cilat në eventualitetin e pranimit të kësaj kërkesë, mund të vihen seriozisht në pikëpyetje. Nga ana tjetër, në kushtet kur pakica parlamentare vlerëson se këto ndryshime vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, ajo nuk ka paraqitur propozimet e

saj për kryesitë e komisioneve parlamentare (kryetar, zëvendëskryetar), ashtu si edhe përbërjen e këtyre komisioneve. Kjo do të thotë se deputetët e pakicës parlamentare nuk do të jenë pjesëmarrës efektivisht në veprimtarinë parlamentare, deri në momentin që Gjykata Kushtetuese të shprehet me vendim lidhur (anti)kushtetutshmërinë e ndryshimeve të njëanshme në numrin, emërtimin, fushat e përgjegjësisë dhe përbërjen e komisioneve parlamentare. Në alternativë të këtij kërkitimi, trupa gjykuese mund të vlerësojë edhe shqyrtimi me procedurë të përshpejtuar për shkak të rëndësisë dhe emergjencës që ka çështja objekt gjykimi.

IV. KONKLUZIONE

50. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në kushtet kur vendimi nr. 57, datë 16.09.2025 i Kuvendit të Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar:

- (i) Cënon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, pasi reflekton një ndërhyrje flagrante të pushtetit ekzekutiv (kryeministrit) në kompetencën kushtetuese të pushtetit legjislativ (Parlamentit) për vetërregullimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij;
- (ii) Është shqyrtuar dhe miratuar gjatë një mbledhje të seancës plenare të Kuvendit të thirrur në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të Kushtetutës, dhe nenin 27/1, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, e për rrjedhojë vetë mbledhja dhe vendimmarrjet e tij nuk sjellin asnjë pasojë, janë nul;
- (iii) Është shqyrtuar dhe miratuar nëpërmjet procedurës së përshpejtuar pa respektuar kalimin e afatit 1-javor të sanksionuar në nenin 83, pika 2, të Kushtetutës, dhe nenin 28, pika 4, të Rregullores së Kuvendit;
- (iv) Ka cënuar parimin e demokracisë përfaqësuese, në drejtim të lirisë së shprehjes, pasi deputetëve, në kundërshtim me nenet 1, 2, 70, 75, pika 2, të

Kushtetutës, dhe nenet 46, 48 të Rregullores së Kuvendit, iu mohua e drejta e fjalës;

në mbështetje të neneve 1, 2, 7, 70, 75, 76, 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë, neneve 45, 49 dhe 50, të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, *përfundimisht*,

KËRKOJMË:

- (i) Shfuqizimi i vendimit nr. 57, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Shqipërisë.
- (ii) Pezullimin e vendimit nr. 57, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar.

Bashkëlidhur gjeni:

- (i) Vendimin nr. 57, datë 16.09.2025 i Kuvendit të Shqipërisë;

Me konsideratë,

D E P U T E T Ë T

1- Giezment Berolli ~~Refleksi~~

2- Ina Zhapa ~~Th~~

3- Qerd Bylykshut ~~(Qing)~~

4- Kleva Bollin ~~Qleva~~

5- Bhefan Nollberti ~~Qleva~~

6- Kastriot Zicoli ~~Qleva~~

7/7ra shah ~~Th~~

8- Kilit ~~Th~~ pot

9) Greta Zendele ~~Qleva~~

10) Qent Stromunli ~~Qleva~~

11) Albore Velshi ~~Qleva~~

12- ISUP CERB ~~Qleva~~

13. Jovide Tedsolen

14 Fidal Krokka ~~Qleva~~

15. Ledimas Aloli ~~Qleva~~

16. Ramchen Likog ~~Qleva~~

17. Glacuum / Haste ~~Qleva~~

18. Loscama Bog ~~Qleva~~

19. Si ~~Qleva~~

- 20 - Ajroni Gjekmarku
- 21 - Elda Hoti CH
- 22 - DESART XHAFERI
- 23 - BELIND KENIÇI Belind Kulu
- 24 - Xhela Azir gjetur
- 25 - Juan Daci shkëlqim
- 26 - Eno Boti shkëlqim
- 27 - Tomor Alieti
- 28 - Shkur Nedim
- 29 - Arben Lika
- 30 - Ivi Koso
- 31 - Plandi Simi
- 32 - Arvan Ndoja
- 33 - Fikretina Kaga
- 34 - Zija Ismaili
- 35 - Denisa Vota
36. Zija Zija
37. Tedi Blushi
38. ERISA XHIXHO
39. Brunilda Haxhiu